

URDHËR

PËR

Marrjen e masave në zbatim të Ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” dhe VKM për “Caktimin e datave 10-23.03.2020, ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur”,

Në zbatim të Ligjit Nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, VKM-së nr. 651 datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” të ndryshuar, Ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” dhe VKM për “Caktimin e datave 10-23.03.2020, ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur”

U R D H Ë R O J:

1. Nuk do të ofrohet asnjë shërbim për operatorët ekonomikë pranë zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
2. Shërbimi i korespondencës, protokollit në DPD do të spostohet jashtë ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe nuk do të lejohet asnjë person, jo personel brenda ambienteve të DPD-së. Zyra e protokollit do të tërheqë korespondencën çdo ditë në orën 14:00.

Do të instalohet këndi info-point ku do të afishohen adresat e e-mail për çdo drejtori, si dhe numrat e kontaktit të info-point si më poshtë:

069 244 544 4 nga ora 08:00 – 12:00

068 444 002 5 nga ora 12:00 – 16:00.

3. Pezullimin e të gjithë kontrolleve të planifikuara pranë ambjenteve të operatorëve ekonomikë në terren nga strukturat e DPD-së dhe rretheve. Konkretisht kontrollet e mbikqyrjes doganore/ akcizës/ regjimeve doganore. Kontrollet e mbikqyrjes doganore emergjente do të vijojnë sipas procedurave ligjore, ndërsa përjashtim nga kjo pikë bëjnë strukturat e Antikontrabandës, Informacionit, Antitrafikut.

4. Shërbimet ndaj operatorëve ekonomikë të kryhen on-line për sa është e mundur me qëllim minimizimin e kontakteve me përfaqësuesit e operatorëve.

5. Vijimin e procedurave operationale në zonat dhe Degët Doganore. Ndalohet grumbullimi përfaqësuesve të Operatorëve ekonomikë pranë sporteleve të Degëve Doganore. Të respektohet distanca e ofrimit të shërbimit me së paku 1 metër. Të zbatohet me rigorozitet Rregullorja e Degevë Doganore në lidhje me hyrje-daljet e perfaqësuesve të operatorëve ekonomikë.

6. Zbatimi i VKM për “Caktimin e datave 10-23.03.2020, ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur” duke reduktuar numrin e punonjësve në zyra. Çdo sektor do të përcaktojë grafikë shërbimi në sektorët përkatës. Çdo Drejtor Drejtorie/Kryetar Degë Doganore të përcaktojë punonjësit që do të kryejnë detyrën nga shtëpia dhe dërgimin e kësaj liste pranë Sektorit Help Desk duke vënë në dijeni ZV. Drejtorin Administrativ me qëllim krijimin mundësive nëpërmjet Drejtorisë TIK. Këto grafikë shërbimi përkatësisht punonjësit që do të paraqiten në punë dhe punonjësit që do të kryejnë shërbimin nga shtëpia miratohen nga Drejtori i Drejtorisë/Kryetari i Degës Doganore dhe depozitohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerezore.

7. Punonjësit e shërbimit 6 orësh, përveç specialistëve info-point dhe shërbimit sanitar, nuk do të paraqiten në vendin e tyre të punës deri në datën 23.03.2020, me përjashtim të rasteve kur Drejtorët e Drejtorive/Kryetarët e Degëve Doganore kanë nevoja emergjente për shërbimet e tyre.

8. Marrjen e masave për dezinfektimin e ambienteve të punës të DPD dhe Degëve Doganore, si dhe të sigurohet pajisja e personelit doganor operacional me mjete mbrojtëse maska, doreza etj.

9. Pezullohen të gjitha proceset gjyqësore në zbatim të Vendimit nr. 127 datë 10.03.2020 i Këshillit të Lartë gjyqësor.

10. Pezullohen të gjitha aktivitetet, trajnimet të planifikuara për kryerje përgjatë periudhës 10-23.03.2020.

11. Ngarkohen të gjithë Departamentet, Drejtoritë e varësisë pranë Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Degët Doganore për zbatimin e këtij Urdhëri.

12. Ky Urdhër, i cili hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet deri në datë 23.03.2020, mund të jetë objekt rishikimi në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që do të dalin në kuadër të situatës epidemike në Republikën e Shqipërisë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE

Gjon Bardhi